

V E N D I M
Nr. 307, datë 27.6.2002

PËR RRYTJEN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Paga bazë minimale mujore për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, fizik a juridik, vendas ose i huaj, caktohet 9 400 lekë në muaj.
 2. Vendimi nr.423, datë 11.6.2001 i Këshillit të Ministrave "Për rritjen e pagës minimale në shkallë vendi" shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI